



Shërbime rehabilitimi dhe riintegrimi brenda sistemit të mirëqenies sociale në Republikën e Shqipërisë për gratë e mbijetuara nga dhuna

Shqipëri, 2021

Autoret e raportit

Mirela Arqimandriti

Ines Leskaj

Tabela e Përmbajtjes

AKRONIME	3
FALENDERIM	3
HYRJE	4
RISHIKIMI I KUADRIT LIGJOR	4
METODOLOGJIA	8
PËRVOJAT E GRAVE, MBIJETUESE TË DHUNËS NË MARRJEN E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NGA QENDRAT E SHËRBIMEVE SOCIALE	9
INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH GRAVE, PËRDORUESE TË SHËRBIMEVE,	9
MASAT E MBROJTJES DHE MASAT E SIGURISË SË GRAVE PËRDORUESE TË SHËRBIMEVE.....	10
VLERËSIMI I SITUATËS AKTUALE TË SIGURISË SË GRAVE PËRDORUESE TË SHËRBIMEVE	11
INFORMACION MBI SHËRBIMET MBËSHTETËSE / QENDRA PËR PLANIN E SHËRBIMEVE TË PUNËS SOCIALE	11
VLERËSIMI I TRAJTIMIT TË GRAVE PËRDORUESE TË SHËRBIMEVE TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE SOCIALE.....	15
REAGIMI AKTUAL I QENDRËS SË SHËRBIMEVE SOCIALE MBI NEVOJAT E GRAVE PËRDORUESE TË SHËRBIMEVE .	16
PËRFUNDIME	17
PËRVOJAT E GRAVE QË I KANË MBIJETUAR DHUNËS DHE QË KANË MARRË MBËSHTETJE NGA ORGANIZATA E GRAVE	17
PËRFUNDIME	19
REFERENCAT	20

Akronime

RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
QSHS	Qendra të Shërbimeve Sociale
GADC	Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”
DhBGJ	Dhuna me bazë gjinore
LMDhF	Ligji për Masat kundër Dhunës në Familje
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJQ	Organizatat joqeveritare

Falenderim

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” dëshiron të falenderojë 10 organizatat lokale, anëtarët e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe ekipin e intervistuesve që mbledhën të gjithë informacionin përmes intervistimit të grave përdoruese të shërbimeve. Një falenderim i veçantë shkon për Esmeralda Hoxha dhe Megi Zylali, anëtarët e ekipit të QAGjZh të cilat drejtuan procesin e intervistave dhe mbledhjen e të dhënave përmes pyetsorit elektronik.

Hyrje

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" (GADC)¹ dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)² po zbatojnë në Shqipëri projektin rajonal: *"Institucionalizimi i Programeve të Rehabilitimit dhe Riintegritimit Cilësor për të Mbijetuarat e Dhunës"*. Projekti po zhvillohet që prej vitit 2019 në bashkëpunim me një rrjet organizatash kundër dhunës me bazë gjinore, që veprojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor, të udhëhequra nga Qendra e Grave Autonome, në Serbi.³

Projekti synon të përmirësojë legjislacionin dytësor/programet dhe institucionalizimin e shërbimeve cilësore për të mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore (DhBGj). Rezultati i projektit do të konsistojë në një përmirësim cilësor të shërbimeve të rehabilitimit dhe integritimit për të mbijetuarat e DhBGj në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përfshirë Shqipërinë.

Projekti gjithashtu përfshin edhe rezultatet e mëposhtme/rezultatet e pritura: 1) Mbështetja e grave për të lënë autorët e dhunës dhe për t'u bërë më autonome, 2) Propozime cilësore të bazuara në prova për legjislacionin sekondar dhe programe për të ndihmuar të mbijetuarat, 3) Përmirësimi i aftësive të ofruesve të shërbimeve në rritjen e mbrojtjes / sigurisë së të mbijetuarave, 4) Forcimin e rrjetit rajonal për adresimin e dhunës ndaj grave në përputhje me standardet e BE-së.

Në këtë kontekst, QAGjZh dhe RrFGSh zbatuan metodologjinë e projektit për të kuptuar nivelin e shërbimeve të ofruara për gratë dhe vajzat të mbijetuara nga DhBGj. Ky raport do të shërbejë si një bazë dhe do të sjellë informacion në tre aspekte:

1. Përvojat e grave dhe vajzave të mbijetuara nga DhBGj në qendrat e mbështetjes së grave në Shqipëri;
2. Përvojat e grave dhe vajzave të mbijetuara nga DhBGj në qendrat e shërbimit të OJQ-ve;
3. Një hartë e shërbimeve mbështetëse për gratë viktime të Dhunës në Familje në përputhje me Konventën e Stambollit.

Ky raport mat përvojat e grave të mbijetuara nga dhuna, përdoruese të shërbimeve në marrjen e mbështetjes nga qendrat e shërbimeve sociale dhe shërbimet e ofruara nga OShC-të e grave. Ky raport sjell informacion mbi strehat dhe shërbimet e tjera për gratë e mbijetuara nga dhuna në familje gjatë 12 muajve të fundit.

Rishikimi i Kuadrit Ligjor

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur gjithashtu si Konventa e Stambollit⁴, u miratua në Prill 2011 dhe hyri në fuqi në 2014. Shqipëria ka qenë një nga nënshkruesit e saj të parë. Konventa e Stambollit bazohet në

¹ www.gadc.org.al

² <https://awenetwork.org/?lang=en>

³ <https://www.womenngo.org.rs/en/about-us/ongoing-projects/1549-2019-2022-institutionalizing-quality-rehabilitation-and-integration-services-for-violence-survivors> s

⁴ Council of Europe, 2011. Istanbul Convention. Retrieved from <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046031c>

njohjen ndërkombëtare që dhuna ndaj grave është një formë e dhunës me bazë gjinore që kryhet ndaj grave sepse ato janë gra. Shtetet palë janë të detyruara të adresojnë plotësisht të gjitha format e dhunës ndaj grave, të marrin masa për ta parandaluar atë, për të mbrojtur viktimat e saj dhe për të ndjekur penalisht autorët e krimit. Ndonëse qëllimi përfundimtar i Konventës së Stambollit është parandalimi i dhunës, ajo parashikon kërkesa specifike për të mbrojtur viktimat nga dhuna e mëtejshme dhe për t'i ofruar mbështetje dhe ndihmë për të kapërcyer dhunën dhe për të rindërtuar jetën e tyre. Ekziston një pranim i gjerë që shërbimet më të mira të mbështetjes ofrohen nga organizata joqeveritare të specializuara (OJQ), shpesh të drejtuara dhe të menaxhuara nga gra, të cilat janë krijuar për të adresuar nevojat specifike të viktimave të mbijetuara. Autoritetet publike gjithashtu mund të ofrojnë shërbime të tilla si shërbime sociale, shërbime shëndetësore, ndihmë juridike dhe mbështetje ndaj viktimave. Ekziston gjithashtu një përgjegjësi nga autoritetet publike për të identifikuar viktimat e mbijetuara dhe për t'ju ofruar atyre mbështetje.

Shqipëria si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është zotuar të zbatojë Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), e cila përcakton udhëzime të qarta në lidhje me parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen, masat ligjore dhe mekanizmat e monitorimit.

Sipas Institutit Shqiptar të Statistikave, gjatë vitit 2019 në Shqipëri 3,372 gra kanë raportuar dhunë në familje në rajonet e policisë të zonave përkatëse.⁵ Për më tepër, gjatë vitit 2019, janë regjistruar 5,051 gra të lënduara për shkak të veprave penale kundër tyre. Nga këto shifra 315 janë vajza, ndërsa 18.7% e tyre janë viktima të krimeve seksuale⁶.

Kapitulli IV i Konventës së Stambollit ka si qëllim pasjen e një strukture mbështetëse shumëplanëshe, profesionale dhe të orientuar drejt viktimave për çdo grua që ka përjetuar ndonjë nga format e dhunës të mbuluara nga Konventa. Për të përmbushur këto kërkesa, palët duhet të ofrojnë shërbime të specializuara dhe të përgjithshme mbështetëse dhe të sigurojnë që viktimat të mund të kenë lehtësi në qasje ose t'i referohen shërbimit të duhur. Për më tepër, ky kapitull thekson se legjislacioni dhe mekanizmat e tjerë mbështetës janë krijuar në mënyrë që të sigurojnë që të gjithë të mbijetuarit të kenë qasje në shërbime drejt rehabilitimit nga dhuna. Këto shërbime përfshijnë: këshillim juridik dhe psikologjik, ndihmë financiare, strehim, arsimim, trajnim dhe ndihmë në gjetjen e punës.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) si autoriteti kryesor i ngarkuar me detyrën për të mbështetur dhe mbikëqyrur krijimin e mekanizmave të koordinimit të referimit që nga miratimi i Ligjit për Masat kundër Dhunës në Familje (LMDhF) në 2006 dhe themelimi i mekanizmave të referimit bazuar në vendimin përkatës ekzekutiv të vitit 2011.

Detyrimet e përgjithshme (neni 18), të Konventës së Stambollit, duke iu referuar në veçanti bashkëpunimit midis sa më shumë agjencive për të adresuar kompleksitetin e dhunës ndaj grave kërkojnë krijimin e një sistemi ndërhyrjeje që përfshin të gjithë sektorët relevantë të politikave, nivelet administrative dhe aktorët e tjerë. Ndërhyrjet multi-sektoriale dhe midis shumë agjencive në nivel kombëtar dhe lokal janë thelbësore për të siguruar një përgjigje efektive dhe kohezive ndaj të gjitha formave të dhunës. Për më tepër, koordinimi efektiv në nivel lokal është

⁵ INSTAT, 2020. Women and Men in Albania. Retrieved from <http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2020/burrrat-dhe-grat%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2020/>

⁶ Ibid.

veçanërisht i rëndësishëm përsa i përket sigurimit se përgjigjet përshtaten me nevojat e komunitetit dhe ofrimit të një "one-stop shop" të shërbimeve për viktimat.

Detyrat dhe përgjegjësitë e lëna nga raporti i Grupit të Ekspertëve për Veprimin Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) për autoritetet shqiptare, në vitin 2017 përfshijnë:

- Miratimin e masave të nevojshme, përfshirë masat legislative, për të siguruar që bashkëpunimi ndërinstitucional nën mekanizmat e referimit të shtrihet tek viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave;
- Vazhdimin e përpjekjeve të tyre për të pajisur të gjitha bashkitë me një mekanizëm referimi plotësisht funksional;
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional midis të gjithë anëtarëve të mekanizmave të referimit, përfshirë në veçanti zyrtarët gjyqësorë dhe përmbaruesit gjyqësorë publikë dhe privatë, duke promovuar një ndjenjë pronësie dhe përgjegjësie për qëllimin e përbashkët për çrrënjosjen e dhunës ndaj grave;
- Të zhvillojnë aftësitë e mekanizmave të referimit për të siguruar viktimat me një paketë gjithëpërfshirëse të shërbimeve me qëllim fuqizimin e tyre;
- Të sigurojnë qëndrueshmërinë strukturore dhe financiare të mekanizmave të referimit në terma afatgjatë dhe të minimizojnë përçarjet e shkaktuara nga qarkullimi i shpeshtë i personelit;
- Të përfitojnë nga mësimet e marra nga mekanizmat ekzistues të referimit, përfshirë këtu shfaqjen e modeleve të suksesshme të reagimit të koordinuar të komunitetit.

Ligji 121/2016 *"Për Shërbimet e Kujdesit Social në Republikën e Shqipërisë"*⁷ përcakton shërbimet e sigurimeve shoqërore që duhet të ofrohen në mënyrë që çdo qytetar në Republikën e Shqipërisë të realizojë të drejtat e tij për sigurimin shoqëror dhe mbrojtjen.

Sipas ligjit 139/2015⁸, bashkia është institucioni përgjegjës për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë (neni 54, ligji 139/2015). Shërbimi social shtetëror, mbledh dhe analizon të dhëna për ofruesit e shërbimeve dhe përfituesit nga sistemi i kujdesit shoqëror në qendrat ditore rezidenciale / komunitare.

- Shërbimet shoqërore publike ofrohen në institucionet rezidenciale dhe qendrat ditore, të cilat financohen nga buxheti i shtetit. Këto institucione ofrojnë shërbime për fëmijë jashtë kujdesit prindëror dhe me probleme sociale, për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e trafikimit (gra, vajza, fëmijë dhe emigrantë) ose individë me nevoja të veçanta.
- Shërbimet shoqërore jopublike ofrohen nga OJQ-të. Këto shërbime që ofrohen në komunitet janë të shpërndara kryesisht në qytete të mëdha. Shërbimet jo-publike financohen kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë.

Shërbimet shoqërore publike ofrohen në 30 qendra rezidenciale dhe 119 qendra ditore komunitare / shoqërore, ndërsa shërbimet shoqërore jopublike ofrohen nga OJQ ose organizata

⁷ Law 121/2016 "on Social Care Services in the Republic of Albania. Retrieved from <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2019/09/Ligj-nr-121-dt.-21.11.16.pdf>

⁸ Law for Local Self Government. Retrieved from https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

fetare në 86 qendra komunitare / qendra të kujdesit ditor dhe 41 qendra rezidenciale, gjithsej 276 qendra shërbimi.

Shërbime publike dhe jopublike për gratë				
Rrethi	Vendbanimi		Komuniteti	
	Publik	Jo-Publik	Publik	Jo-Publik
1.Tiranë	2	2	5	
2.Durres				1
3.Gjirokastrë				
4.Lezhë		1		
5. Berat				
6. Dibër				1
7. Elbasan		1	3	
8. Kukës				
9. Korçë		2		
10. Fier	1	1		1
11. Vlorë	1			3
12. Shkodër		1	1	
Total	4	8	9	6

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, 2019

Siç është e qartë nga kjo tabelë, shërbimet për gratë në nevojë janë shumë të pakta, rreth 8% e numrit të përgjithshëm të shërbimeve. Për më tepër, gratë beqare me fëmijë si dhe pensionistet beqare janë grupet më të përjashtuara në Shqipëri të ndjekura nga "individët me aftësi të kufizuara" dhe "përfituesit e ndihmës ekonomike". Të rinjtë dhe gratë e papuna janë gjithashtu në kushte kritike të përjashtimit.⁹

Përveç ligjit Ligji 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Social në Republikën e Shqipërisë", akti nënligjor nr. 518, datë 2018, përcakton kriteret dhe procedurat për marrjen e shërbimeve të kujdesit në institucionet e komunitetit dhe rezidencës, sipas llojit të shërbimit dhe kategorisë përkatëse së përfituesit dhe shumës së shpenzimeve personale për përfituesit e shërbimit.¹⁰

Për më tepër, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015 - 2020¹¹, adreson përgjegjësinë e Qeverisë së Shqipërisë në lidhje me (i) skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, (ii)

⁹ State Social Service 2019. Assessment of the need for social services in 12 regions of Albania. Retrieved from <https://ëëë.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/vleresimi-i-nevojes-per-sherbime-shoqerore-ne-12-qarqet-e-shqipe.html>

¹⁰ http://ëëë.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2014/03/VKM-518_dt_04.09.2018.pdf

¹¹ National Social Protection Strategy, 2016 – 2020. Retrieved from, https://shendetesia.gov.al/ëp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf

shërbimet e kujdesit shoqëror ekzistues dhe ato të propozuara dhe (iii) çdo çështje tjetër në fushën e mbrojtjes sociale. Kjo strategji është hartuar në përputhje me nenet 70 dhe 99 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Dokumenti i Partneritetit 2007 dhe përmbush detyrimet që rrjedhin nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2014-2020.

Një nga politikat e strategjisë është zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive në shoqëri.

Kuadri ligjor i përmendur më sipër është i ndërthurur me ligjin dhe strategjitë e tjera. Bazuar në këtë kuadër ligjor, Shqipëria mund të sigurojë një sistem gjithëpërfshirës të mbrojtjes për gratë viktime të dhunës në familje. Sidoqoftë, Shqipëria është ende larg shërbimit ndaj kësaj kategorie vulnerabël.

Metodologjia

Për të matur nivelin e kënaqësisë me qendrat e shërbimit për gratë ose nga mekanizmi i referimit, u intervistuan gra dhe vajza që mbijetuan nga dhuna në marrëdhëniet familjare, rreth 91 gra dhe vajza nga 10 bashki të ndryshme. Gratë u kontaktuan përmes organizatave anëtare të RrFGSh si më poshtë:

1. Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” – Tiranë
2. Qendra Vatra – Vlorë
3. Shoqata Jona – Sarandë
4. Gruaja te Gruaja – Shkodër
5. Unë Gruaja – Pogradec
6. Agrita Vizion – Dibër
7. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza – Tiranë
8. Forumi i Gruas – Elbasan
9. Gruaja, Paqe dhe Siguri – Durrës

Anëtarët e organizatës u trajnuan dhe diskutuan se si të mbledhin informacionin përmes kryerjes së intervistave. Qëllimi i intervistimit ishte përcaktimi i nevojave që kishin gratë e mbijetuara nga dhuna dhe çfarë informacioni dhe mbështetje kishin marrë në qendrat e shërbimeve sociale, si dhe nivelin e kënaqësisë së grave, përdoruese të shërbimeve me mbështetjen e ofruar.

Intervistimi u krye nga këshilltaret gra të organizatave të sipërpërmendura, pjesë e Rrjetit të Fuqizimit të Grave Shqiptare (RrFGSh). Sondazhi u drejtua nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh). Sondazhi është i standardizuar për të gjitha organizatat pjesë e projektit me njëzet e tetë (28) pyetje që përqendrohen në mbledhjen e të dhënave të mëposhtme:

- a) Informacion i përgjithshëm rreth grave, përdoruese të shërbimeve,
- b) Të dhëna për masat mbrojtëse dhe ato të sigurisë të kërkuara dhe / ose të zbatuara nga qendrat e shërbimeve sociale dhe institucionet e tjera publike të njohura si subjekte të mbrojtjes në lidhje me gratë përdoruese të shërbimeve,
- c) Të dhëna për shërbimet e mbështetjes / planit të shërbimeve të qendrat e shërbimeve sociale në lidhje me gratë përdoruese të shërbimeve,
- d) Vlerësimi i qëndrimeve ndaj grave, përdoruese të shërbimeve në qendrat e shërbimeve sociale

Gjatë kryerjes së intervistave, intervistuesit iu shpjeguan grave të intervistuar qëllimin e mbledhjes së të dhënave dhe se përgjigjet e dhëna do të analizohen në mënyrë anonime (pa regjistruar emrin e tyre ose pa ndarë përgjigjet e tyre specifike me ndonjë nga institucionet, si edhe një grua ka mundësi që të refuzojë të ndajë informacion apo përvojën e saj.

Intervistuesit, morën në intervistë gjithsej 91 (nëntëdhjetë e një) gra, përdoruese të shërbimeve, dhe analiza e të dhënave dhe përvojave janë paraqitur në këtë raport duke ndjekur strukturën e studimit të standardizuar.

Gjetjet e këtij raporti do të përdoren nga QAGjZh dhe RrFGSh për raportin hije CEDAW dhe raportin e progresit të GREVIO ose të KE për Shqipërinë. Gjithashtu, gjetjet do të përdoren për të përshtatur trajnimin e profesionistëve në qendrat e shërbimeve sociale drejt përmirësimit të shërbimeve të mbështetjes së qendrave për punë sociale për gratë mbijetuese të dhunës. Për më tepër, gjetjet do të diskutohen në një tryezë të rrumbullakët me institucionet përgjegjëse për të përmirësuar shërbimet për gratë e mbijetuara të dhunës në familje.

Përvojat e grave, mbijetuese të dhunës në marrjen e shërbimeve mbështetëse nga qendrat e shërbimeve sociale

Informacion i përgjithshëm rreth grave, përdoruese të shërbimeve,

Mosha e grave të intervistuar varion nga 17 në 58 vjeç, 10 (dhjetë) prej tyre ishin të grupmoshës 17 - 20 vjeç, 10 (dhjetë) ishin 21-25 vjeç, 19 (nëntëmbëdhjetë) ishin 25-35 vjeç, 32 (tridhjetë e dy) ishin 35-45 vjeç dhe 20 (njëzet) ishin 45 - 58 vjeç.

Të gjithë të anketuarit ishin shtetase shqiptare, 3 (tre) prej tyre Rome dhe 2 (dy) Egjiptiane. Në lidhje me karakteristikat specifike personale **7 (shtatë) gra dhe vajza thanë se kishin një paaftësi**, 2 (dy) prej të cilave janë me paaftësi fizike dhe 4 (katër) prej tyre kishin probleme të çrregullimit depresiv, njëra tha që ajo ka një dëmtim të veshkave për shkak të dhunës fizike.

56 (pesëdhjetë e gjashtë) gra kanë fëmijë të mitur, 17 (shtatëmbëdhjetë) prej tyre kishin fëmijë të mitur dhe të rritur, 11 (njëmbëdhjetë) nuk kishin fëmijë dhe 7 (shtatë) prej tyre kishin fëmijë të rritur. Gjashtëdhjetë e dy (62) gra të intervistuar e identifikuan veten si nëna beqare, të cilat sipas legjislacionit në Shqipëri gjithashtu quhen kryefamiljare, njëzet e dy (22) gra të intervistuar nuk e identifikuan veten si nëna beqare, 7 (shtatë) prej tyre refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Në lidhje me **statusin e punësimit**, 45 (dyzet e pesë) nga të intervistuarit janë të papuna, 35 (tridhjetë e pesë) deklaruan se janë të punësuar dhe 8 (tetë) ishin duke punuar me kohë të pjesshme. Këto të fundit thanë se punojnë sa herë që gjejnë një punë. Kjo do të thotë që këto gra dhe një e papunë nuk kanë mbulim të sigurimeve shoqërore. 2 (dy) të intervistuar po ndjekin shkollën e mesme, dhe 1 (një) universitetin dhe është nënë me fëmijë të mitur.

Në lidhje me strehimin, shumica e grave 37 (tridhjetë e shtatë) prej tyre jetojnë në apartamentet e prindërve ose të të afërmeve të tyre, 38 (tridhjetë e tetë) jetojnë në shtëpi me qira, 16 (gjashtëmbëdhjetë) kanë apartamentet e tyre.

Shumica e grave të intervistuar 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) raportuan se kanë vuajtur të gjitha format e dhunës dhe nuk mund të bëjnë dallimin midis formave, 12 (dymbëdhjetë) kanë

deklaruar se kanë pësuar dhunë seksuale dhe 3 (tre) deklarojnë se kanë vuajtur dhunë psikologjike / emocionale.

Përgjigjet e grave të intervistuar, përdoruese të shërbimeve tregojnë se shumica e tyre ishin **të ekspozuara ndaj një dhune afatgjatë**. 38 (tridhjetë e tetë) gra deklaruan se vuanin dhunë ndaj tyre nga 1 deri në 2 vjet; 18 (tetëmbëdhjetë) gra deklaruan se vuanin dhunë nga 3-6 vjet; 20 (njëzet) gra deklaruan se vuanin nga 7-10 vjet dhe 22 (njëzet e dy) gra vuanin dhunë në familje për 10 - 20 vjet; vetëm një grua deklaroi se volante prej 30 vitesh dhunë ekstreme.

Në lidhje me pyetjen **se sa herë ka ndodhur dhuna gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të fundit**, 55 (pesëdhjetë e pesë) gra kanë deklaruar se dhuna ka ndodhur disa herë gjatë kësaj periudhe, 7 (shtatë) kanë deklaruar se dhuna ka qenë e vazhdueshme para se ta raportonin atë, 5 (pesë) raportuan dhunë brenda dy muajve të fundit dhe autorët e tyre janë në burg dhe pjesa tjetër 24 (njëzet e katër) deklaruan se nuk kishin pësuar dhunë gjatë kësaj periudhe.

Masat e mbrojtjes dhe masat e sigurisë së grave përdoruese të shërbimeve

Gratë e intervistuar thanë se për shkak të dhunës në 12 muajt e fundit, 14 (katërmëdhjetë) gra morën Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes brenda 48 orëve. Asnjë nga gratë e intervistuar nuk ka një urdhër paraprak mbrojtjeje (24 orë). Të gjitha morën urdhër të zgatur mbrojtje për 30 ditë dhe më shumë.

Sipas nenit 17/3 të Ligjit Nr. 966/2006 "*Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare*" (LDHF)¹² gjykata cakton urdhra mbrojtje dhe vendos për: 1) Kohëzgjatjen e masës e cila fillon nga 30 ditë; 2) Njoftimin e dhunuesit se shkelja e urdhrit të mbrojtjes përbën vepër penale siç përcaktohet në nenin 320 të Kodit Penal; 3) E drejta e ankimit brenda 15 ditëve. Për më tepër, sipas nenit 19/3 të ligjit¹³, vendimi i gjykatës përfshin datën e seancës, e cila është brenda 20 ditëve nga lëshimi i vendimit të gjykatës dhe urdhrit të mbrojtjes.

Më tej, gratë përdoruese të shërbimeve u pyetën nëse **masat emergjente zbatoheshin edhe për fëmijët**. 75% e grave u përgjigjën po ndërsa 25% u përgjigjën jo. Masat e mbrojtjes përfshinin 16 (gjashtëmbëdhjetë) autorë në burg, 6 (gjashtë) në arrest shtëpie dhe urdhër për të mos iu afruar gruas ose fëmijëve, 5 (pesë) çështje janë në proces në gjykatë, megjithatë dhunuesi është urdhëruar të largohet nga shtëpia; 6 (gjashtë) gra dhe fëmijët e tyre janë vendosur në strehëzat për viktimat e dhunës në familje dhe ishin akoma atje në momentin e intervistës; 13 (trembëdhjetë) kanë një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje. Në momentin e intervistës 6 (gjashtë) gra raportuan se ishin divorcuar ose janë në proces divorci ndërsa procedurat penale për dhunuesit e tyre po vazhdojnë, 39 (tridhjetë e nëntë) gra nuk janë përgjigjur. Të gjitha gratë raportuan se kanë marrë Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes kur kanë raportuar dhunën dhe të gjitha masat janë aplikuar edhe për fëmijët.

¹² Ligji për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Retrived from <https://ëëë.parlament.al/Files/Akte/20201020140600ligj%20nr.%20125%20dt.%2015.10.2020.pdf>

¹³ ibid

Vlerësimi i situatës aktuale të sigurisë së grave përdoruese të shërbimeve

Në lidhje me sigurinë e grave të mbijetuara 71 (shtatëdhjetë e një) thanë se tani, pasi raportuan ndihën të sigurt, për 12 (dymbëdhjetë) gra situata mbeti e njëjtë dhe për 8 (tetë) ajo është përkeqësuar.

Disa citate nga gratë e dhunuara:

"Jam më e qetë pasi abuzuesi im është në burg"

"Ndihej e sigurtë pranë nënës time"

"Ndihej më e qetë dhe më e mbrojtur pasi jam strehuar në strehëz"

"E lashë babanë tim abuzues dhe u strehova pranë qendrës Vatra. Ndihej më e sigurtë pasi jam vendosur në strehëz."

"Situata ime është më e qetë sepse burri im është dënuar me burg por frika mbetet sepse unë mendoj se çfarë do të më ndodhë në momentin që burri im do të jetë i lirë pasi është e sigurtë që do të hakmerret ndaj meje"

"Ish-bashkëshorti është urdhëruar që të mos më afrohet mua apo vajzës time"

Një grua nga Durrësi, 36 vjeç, po ndihet e kërcënuar. Ajo tha se ish-burri i saj i dërgon mesazhe kërcënuese nga burgu. *"Ai kërcënon të më vrasë mua dhe prindërit e mi."* – tha ajo. Një grua tjetër 35-vjeçare deklaroi se burri i saj është i nevrokosur sepse ajo e denoncoi në polici.

Një grua tjetër 36-vjeçare deklaroi se - burri i saj është i nevrikosur sepse ai nuk ka më të drejtë të shohë fëmijët e tij.

Ndërsa në përgjithësi, megjithëse disa gra deklarojnë se janë të sigurt, ato ende kanë frikë dhe pasiguri. Vetëm një deklaratë pozitive erdhi nga një grua 38 vjeç në lidhje me burrin e saj, ajo tha: *"Unë nuk kam pasur ndonjë shqetësim pas lirim të burrit tim nga burgu pasi ai u bë i vetëdijshëm dhe e kuptoi dëmin që po i bënte familjes."*

Informacion mbi shërbimet mbështetëse / qendra për planin e shërbimeve të punës sociale

75 (shtatëdhjetë e pesë) gra të intervistuar përdoruese të shërbimeve, kërkuan ndihmë / iu drejtuan qendrave të shërbimeve sociale gjatë 12 muajve të fundit, ndërsa 12 (dymbëdhjetë) gra përdoruese të shërbimeve nuk i kërkuan shërbimet e tyre brenda kësaj periudhe. Të anketuarat morën shërbime në këto qendra shërbimesh për gratë, të vendosura në bashkitë e mëposhtme: Shkodër, Durrës, Tiranë, Pogradec, Elbasan, Vlorë, Sarandë.

Lidhur me pyetjen nëse Qendra e Shërbimeve Sociale (QShS) ka bërë një plan të personalizuar të shërbimit për gruan dhe fëmijët e saj, nga 91 (nëntëdhjetë e një) përgjigje, 39 (tridhjetë e nëntë) u përgjigjën duke thënë se nuk kishin një plan dhe se nuk e dinë se çfarë është plani, ndërsa 52 (pesëdhjetë e dy) gra përdoruese të shërbimeve thanë se kanë një plan dhe se përpiqen ta ndjekin atë me ndihmën e QShS-së.

Ato që e kanë një plan u pyetën nëse kishin rënë dakord për planin me këshilltarin apo kishin marrë një plan të përgatitur vetëm nga QShS-ja. 38 (tridhjetë e tetë) gra u përgjigjën se ishin

dakord mbi planin, ndërsa 14 (katërbëdhjetë) nuk ishin të sigurt që plani i mbetet qendrës, por se janë të sigurt se kishin diskutuar për një plan.

E pyetur nëse e di **se çfarë është plani** dhe çfarë bëhet me të dhe nëse kjo i është shpjeguar mirë nga këshilltari, ishte e qartë se e mbijetuara nuk kishte shumë për të thënë. Kjo do të thotë që planet nuk hartohen si duhet dhe nuk e mbështesin plotësisht rrugëdaljen e grave. Këshilltarët dhe menaxherët e QShS-ve duhet ta përmirësojnë këtë pjesë të punës.

Të 91 (nëntëdhjetë e një) gratë përdoruese të shërbimeve konfirmuan se kur u ishin afruar qendrave për shërbime sociale, profesionistët në qendër i kishin shqyrtuar nevojat që ato kishin, dhe i kishin informua për të drejtat që kanë si viktima të dhunës.

Në 98% të rasteve, gratë dhe fëmijët e tyre kishin **nevojë për mbështetje psikologjike dhe sociale**, por jo në të gjitha rastet këshilluesi i kishte informuar se si ta merrnin një mbështetje të tillë. Në 68 (gjashtëdhjetë e tetë) raste, gratë përdoruese të shërbimit thanë se profesionistët në qendrën e shërbimeve sociale i kishin informuar rreth mundësisë për të marrë mbështetje psikologjike / sociale, 23 (njëzet e tre) gra thanë se nuk ishin të informuara për këtë. Megjithatë, është e qartë nga përgjigjet që 71 (shtatëdhjetë e një) gra kishin marrë mbështetje nga OSHC-të e grave, 11 (njëmbëdhjetë) nga QShS, 9 (nëntë) gra nuk kishin marrë asnjë shërbim.

Të anketuarat u pyetën nëse në kohën e raportit **kishin nevojë për një vend të sigurt** dhe nëse këshilluesi ua kishte dhënë këtë mundësi. Në 34 (tridhjetë e katër) raste, gratë nuk kishin pasur nevojë për një vend të sigurt, kurse 50 (pesëdhjetë) gra kishin pasur nevojë për një vend të sigurt.

35 (tridhjetë e pesë) gra përdoruese të shërbimeve thanë se nuk kishin marrë informacionin në qendrat e shërbimeve sociale për mundësinë e gjetjes së një vendi të sigurt për të banuar, 45 (dyzet e pesë) gra thanë se e morën këtë informacion në qendër, ndërsa 11 (njëmbëdhjetë) gra përdoruese të shërbimit thanë se nuk ishin të sigurt nëse e kishin marrë këtë informacion.

Gjashtëmbëdhjetë të anketuar informuan se kishin përdorur strehën e ofruar nga QShS, ndërsa pjesa tjetër kishin përdorur alternativa të tjera, si shtëpitë prindërore, shtëpitë e tyre, etj. 48 (dyzet e tetë) gra përdoruese të shërbimeve kishin përdorur një vend të sigurt për të banuar, ndër të cilat 40 (dyzet) ishin strehuar në shtëpitë e sigurt të drejtuara nga organizatat e shoqërisë civile të grave (Vlorë-jug, Shkodër në veri, Tiranë, Elbasan), 8 (tetë) në Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje (Bashkia Kamzë). 43 të tjerat kishin përdorur apartamente të prindërve të tyre, ose apartamentin e vet.

46 (dyzet e gjashtë) prej tyre thanë se fëmijët e tyre banonin në një vend të sigurt së bashku me to, ndërsa 34 (tridhjetë e katër) thanë se fëmijët e tyre nuk kishin qëndruar me to, sepse ishin të rritur. 11 gra nuk kishin fëmijë.

39 (tridhjetë e nëntë) gra përdoruese të shërbimeve thanë **se duhej ta zgjidhnin problemin e tyre të qëndrimit / të gjenin një apartament për të jetuar**, 36 (tridhjetë e gjashtë) gra thanë se nuk e kishin këtë nevojë, ndërsa 16 (gjashtëmbëdhjetë) të intervistuarat nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje.

35 gra përdoruese të shërbimeve thanë se qendra e shërbimeve sociale **nuk i kishte informuar për mundësinë e marrjes së ndihmës për zgjidhjen** e problemit të tyre të banimit, 42 (dyzet e dy) gra thanë se e kishin marrë këtë informacion, 14 (katërbëdhjetë) gra **nuk ishin të sigurt nëse e kishin marrë apo jo një informacion të tillë**.

Vetëm 4 (katër) gra përdoruese të shërbimeve deklaruan se kanë **përdorur ndihmën/shërbimin shtetëror për të zgjidhur** çështjet e tyre të banimit. 87 (tetëdhjetë e shtatë) gra nuk e kishin përdorur kurrë një ndihmë të tillë.

Të pyetura nëse **u duhej ndihmë financiare**, gratë përdoruese të shërbimeve thanë "po" në 78 (shtatëdhjetë e tetë) raste dhe "jo" në 13 (trembëdhjetë) raste.

65 (gjashtëdhjetë e pesë) gra përdoruese të shërbimeve u shprehën se qendra për punë sociale i kishte informuar për mundësinë e marrjes së ndihmës financiare, 17 (shtatëmbëdhjetë) thanë se nuk e kishin marrë këtë informacion në qendrën për punë sociale, ndërsa 9 (nëntë) gra thanë se nuk ishin të sigurta nëse ishin informuar për një mundësi të tillë në qendër apo jo.

3 (tre) gra përdoruese të shërbimeve të intervistuar **u shprehën se kishin përdorur ndihmë financiare një herë**, kurse 47 (dyzet e shtatë) gra përdoruese të shërbimeve thanë se po marrin ndihmë financiare të vazhdueshme, kurse 6 po marrin ndihmë për fëmijët. 35 (tridhjetë e pesë) gra thanë se duke qenë se janë në marrëdhënie pune, nuk kanë marrë ndihmë financiare.

58 (pesëdhjetë e tetë) gra të intervistuar, përdoruese të shërbimeve, **u shprehën se duhet të gjejnë punë**, 31 (tridhjetë e një) përdoruese të shërbimeve thanë se nuk kanë nevojë të gjejnë punë, ndërsa 2 (dy) gra nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje.

52 (pesëdhjetë e dy) gra të intervistuar përdoruese të shërbimeve deklaruan se **qendra e shërbimeve sociale i kishte informuar për mundësinë e marrjes së ndihmës për gjetjen e punës**, 32 (tridhjetë e dy) gra thanë se nuk e kishin marrë këtë informacion në qendër, ndërsa 8 (tetë) nuk donin të përgjigjeshin.

Në shumicën e rasteve, gratë ishin këshilluar për gjetjen e një pune nga punonjësi social, i cili i kishte informuar mbi Zyrën e Punës dhe mundësinë për të marrë trajnim profesional falas. Sidoqoftë, gratë nuk e kishin përdorur shumë këtë mundësi, ato ishin përballur me sfida të ndryshme në përpjekjet për gjetjen e punës nëpër zyra. Ata ishin përballur edhe me më shumë sfida për të vazhduar trajnimet profesionale, sepse në disa raste nuk kishin pasur mundësi t'i linin fëmijët në një vend të sigurt, gjatë kohës që mund të bënin trajnimin.

21 (njëzet e një) nga 56 (pesëdhjetë e gjashtë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur/të varur prej tyre, u shprehën **se duhet t'i vendosnin fëmijët e tyre në kujdes të përkohshëm** dhe të vendosnin një plan të përkohshëm që fëmijët të takohen me babanë e tyre (të dhunshëm), 50 (pesëdhjetë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë deklaruan se nuk e kishin këtë nevojë. 8 (tetë) gra nuk ishin të sigurta se çfarë të bënin në lidhje me këtë.

30 (tridhjetë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur prej tyre, u shprehën se qendra e shërbimeve sociale i **kishte informuar për mundësinë** e marrjes së kujdesit të përkohshëm dhe për mënyrën se si mund të takoheshin me të atin, 44 (dyzet e katër) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur nuk e kishin marrë këtë informacion nga qendra.

39 (tridhjetë e nëntë) gra të intervistuar përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur prej tyre **u shprehën se qendra e shërbimeve sociale i kishte rekomanduar gjykatës të merrte**

masa për kujdesin dhe për vizitat e përkohshme, ndërsa pesëmbëdhjetë 38 (tridhjetë e tetë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur/të varur u shprehën se qendra nuk ia kishte dhënë një rekomandim të tillë gjykatës.

58 (pesëdhjetë e tetë) gra të intervistuar, përdoruese të shërbimeve, me fëmijë të mitur / të varur prej tyre u shprehën se **fëmijët e tyre kishin nevojë për mbështetje psikologjike / sociale**, 12 (dymbëdhjetë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të varur prej tyre/të mitur mendojnë se fëmijët e tyre nuk kishin pasur nevojë për mbështetje psikologjike / sociale, ndërsa 10 (dhjetë) gra përdoruese të shërbimeve thanë se nuk ishin të sigurt nëse fëmijët e tyre kishin pasur nevojë për mbështetje psikologjike / sociale.

60 (gjashtëdhjetë) gra përdoruese të shërbimeve me **fëmijë të mitur / të varur prej tyre, u shprehën se kishin marrë informacion mbi mundësinë e marrjes së mbështetjes psikologjike / sociale** për fëmijët e tyre në qendrën e shërbimeve sociale, 20 (njëzet) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur u shprehën se qendra i kishte informuar për mundësinë e marrjes së mbështetjes psikologjike / sociale.

43 (dyzet e tre) gra të intervistuar, përdoruese të shërbimeve, me fëmijë të mitur / të varur prej tyre, deklaruan se fëmijët **i kishin përdorur shërbimet e mbështetjes psikologjike / sociale**, nga organizata joqeveritare të specializuara, 2 (dy) nga një institucion i specializuar i kujdesit mendor. Vetëm 1 kishte marrë shërbimin e këshillimit për martesën dhe këshillim familjar, 16 (gjashtëmbëdhjetë) thanë se fëmijët e tyre nuk përdornin shërbime të mbështetjes psikologjike / sociale.

35 (tridhjetë e pesë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur thanë **se kishin nevojë për masa mbikëqyrëse të** lëshuara në lidhje me abuzuesin dhe sjelljen e tij prindërore, 17 (shtatëmbëdhjetë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur deklaruan se nuk kishin nevojë për këto masa, ndërsa nëntë 4 (katër) gra përdoruese të shërbimeve nuk ishin të sigurt nëse u duheshin këto masa.

35 (tridhjetë e pesë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur deklaruan se qendra e shërbimeve sociale i kishte informuar për **mundësinë e marrjes së masave të mbikëqyrjes**, 17 (shtatëmbëdhjetë) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur deklaruan se nuk kishin marrë informacion të tillë në qendër, ndërsa 4 (katër) gra përdoruese të shërbimeve u shprehën se nuk ishin të sigurt nëse e kishin marrë një informacion të tillë.

33 (tridhjetë e tre) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur **u shprehën se qendra e shërbimeve sociale kishte iniciuar procedurat për ndërprerjen e pjeshme të të drejtave prindërore të abuzuesit (babait)**, në 2 (dy) raste për nënën; në 1 (një) rast për të dy prindërit, ndërsa 20 (njëzet) gra përdoruese të shërbimeve me fëmijë të mitur / të varur prej tyre deklaruan se qendra nuk e kishte iniciuar një procedurë të tillë. Në kohën e intervistimit, në 34 (tridhjetë e katër) raste, procedura ishte iniciuar nga QPS-ja, por ishte përfunduar pjesërisht, kurse vetëm në 4 (katër) raste, kishte përfunduar plotësisht.

10 (dhjetë) gra të intervistuar si përdoruese të shërbimit u shprehën se kishin disa **nevoja të tjera për mbështetje dhe ndihmë nga qendra e shërbimeve sociale**. 1 (një) grua tha se djali i saj është i varur nga droga dhe i duhet ndihmë për këtë çështje. 4 (katër) gra thanë se kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme psikologjike dhe sociale.

Pothuajse të gjitha gratë vunë në dukje se **QPS-ja i kishte referuar tek OJQ-të e grave** për të marrë lloje të ndryshme ndihme. Për më tepër, të gjitha përdorueset e shërbimeve që u intervistuan u shprehën se nuk kishin përdorur asnjë shërbim tjetër të siguruar nga qendra e shërbimeve sociale. Ato kishin përdorur ndihmën juridike falas të siguruar nga organizata e shoqërisë civile të grave në lidhje me mbrojtjen e të drejtave si të mbijetuara të dhunës ose në lidhje me divorcin nga bashkëshorti abuziv.

Vlerësimi i trajtimit të grave përdoruese të shërbimeve të qendrës së shërbimeve sociale

Kjo pjesë e raportit bazë ofron përvojat e përdorueseve të shërbimeve në komunikimin e drejtpërdrejtë me menaxhuesit e rasteve/profesionistët e qendrave të shërbimeve sociale.

52 (pesëdhjetë e dy) gra përdoruese të shërbimeve që u intervistuan mendojnë se **menaxheri i rastit/profesionisti i fushës në qendrën e shërbimit social kishte demonstruar se i kuptonte**, u besonte dhe i mbështeste. Ndërsa 20 (njëzet) gra përdoruese të shërbimeve shprehën **se nuk e vlerësonin kontaktin dhe ndihmën nga menaxheri i qendrës**. 17 (shtatëmbëdhjetë) gra përdoruese të shërbimeve mendojnë se kanë pasur mirëkuptim dhe mbështetje vetëm pjesërisht, 2 (dy) gra mendojnë se komunikimi ishte katastrofë.

Përdorueset e shërbimeve dhanë këta shembuj praktikash të mira nga profesionistët në qendrat e shërbimeve sociale:

- *"një profesionist në qendrën e shërbimit social më shpjegoi të drejtat e mia dhe përgatitëm një plan"*
- *"profesionistët në qendrën e shërbimit social më ndihmuan të akomodohesha në një strehëz,"*
- *"profesionistët në qendrën e shërbimit social më dhanë mirëkuptim, dhembshuri dhe mbështetje të plotë,"*
- *"profesionistët në qendrën e shërbimit social vlerësuan se unë dhe fëmijët e mi jemi të rrezikuar nga dhuna e përsëritur."*

Përdorueset e shërbimeve dhanë edhe shembuj negativë se si / pse ndiheshin se profesionistët në qendrën e shërbimit social kishin qëndrim përgjithësisht negativ dhe / ose nuk i kuptonin, nuk u besonin dhe nuk i mbështetnin:

- *"Nuk kam parë asnjë menaxher kur vizitoj qendrën".*
- *"Ç'të them! Ishte totalisht katastrofë, u ndjeva keq dhe e lënë pas dore"*
- *"Ata nuk e ndoqën rastin tim dhe unë nuk isha në dijeni të hapave që duhet të ndiqja në gjykatë për të marrë ndihmën ekonomike".*

85 (tetëdhjetë e pesë) gra përdoruese të shërbimeve mendojnë se menaxheri i rastit / profesionistët në qendrën e shërbimit social **nuk e kishin përkrahur abuzuesin / dhunën nga komentet ose qëndrimi i tyre i përgjithshëm**, vetëm 1 (një) nga gratë përdoruese të shërbimeve

u shpreh se kishte pasur komente apo qëndrime të tilla të përgjithshme, ndërsa 5 (pesë) përdorues të shërbimeve nuk ishin të sigurta. Përdorueset e shërbimeve që deklaruan se menaxherët e rasteve / profesionistët në qendrën e shërbimit social nuk e kishin mbështetur abuzuesin / dhunën nga komentet e tyre ose qëndrimi i tyre i përgjithshëm komentuan gjithashtu se profesionistët në qendrën për punë sociale ishin përqendruar në sigurimin e informacionit dhe mbështetjes për to dhe për fëmijët në lidhje me dhunën në familje së cilës ata i kishin mbijetuar dhe nuk kishin justifikuar dhunën ose sjelljen e abuzuesit.

76 (shtatëdhjetë) gra përdoruese të shërbimeve të intervistuar mendojnë se menaxheri i rastit / profesionistët në qendrën e shërbimit social **nuk kishte fajësuar viktimën për dhunën nga komentet e tyre apo qëndrimi i tyre i përgjithshëm**. Sidoqoftë, 4 (katër) gra përdoruese të shërbimeve u shprehën se kishte pasur pjesërisht komente apo qëndrime të tilla, kurse 7 (shtatë) gra mendojnë se këto komente apo qëndrime ishin të pranishme dhe të ushtruara nga disa prej profesionistëve në këto qendra.

Më poshtë janë disa komente nga gratë për qëndrimin e menaxherit të rastit:

- *"Unë prisja që të më ndihmonte qendra shtetërore QShS, kurse ata më dërguan tek OJQ-të e grave që më ndihmuan mua dhe fëmijët e mi".*
- *"Unë nuk kam marrë mbështetjen e nevojshme nga QShS, nuk më bënë asnjë plan shërbimi"*
- *"Nuk më dëgjuan me kujdes kur fola, mendoj se nuk u interesonte"*
- *"Menaxheri i rastit më dërgoi nga një institucion tek tjetri. Nuk më ndihmuan siç duhet.*
- *"U ndjeva e ofenduar nga pritja indiferente e stafit të qendrës, ndoshta nuk kishin fuqi të mjaftueshme për të më ndihmuar"*

Reagimi aktual i qendrës së shërbimeve sociale mbi nevojat e grave përdoruese të shërbimeve

12 (dymbëdhjetë) gra të intervistuar përdoruese të shërbimeve (13.19%) e vlerësojnë reagimin aktual të qendrës së shërbimeve sociale ndaj nevojave të tyre si shumë të pakënaqshme, 11 (njëmbëdhjetë) ose 12.09% e vlerësojnë si të pakënaqshme, pasur nga 17 (shtatëmbëdhjetë) ose 18.68% që e vlerësojnë disi të kënaqshme, pasuar nga 31 (tridhjetë e një) gra përdoruese të shërbimeve (34.07%) që e vlerësojnë si të kënaqshme dhe 20 (njëzet) ose 21.98% si tejet të kënaqshme.

Komentet e përdorueseve të shërbimeve për nivelin e lartpërmendur të kënaqësisë ose pakënaqësisë përfshijnë deklaratat e mëposhtme:

Negativ

"Nuk kisha informacion në lidhje me shërbimet që ofrojnë qendrat"

"Bashkia nuk jep asnjë ndihmë përveç pagesës prej rreth 30 USD, duke qenë se kam urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje".

"Nuk u ndjeva e mbështetur si grua e përdhunuar. Prisja më shumë "

"Nuk kam marrë asnjë ndihmë nga njësia e shërbimit social në nivel bashkie"

"Kam aplikuar për një bonus qiraje, por nuk e kam marrë kurrë"

"Unë ende kam nevojë për mbështetje financiare sepse ish-burri im nuk siguron ushqim për vajzat e mia"

"Aspak e kënaqur"

"Ende nuk kam marrë një bonus qiraje edhe pse jam me urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje"

"Shumë e zhgënjyer nga Gjykata e cila në vendimin e saj të fundit të vitit 2021 e dënoi autorin e krimit me 11 ditë burg për mospagim të pensionit ushqimor".

Pozitiv:

"Sjellja ishte korrekte dhe jodiskriminuese."

"Ndihem e sigurt dhe e qetë. Më dëgjojnë për çdo nevojë që kam. "

"Më dëgjuan dhe unë mora shumë shërbime dhe mbështetje për vete dhe për fëmijët".

"Jam strehuar për disa ditë tek Vatra, ndihem mirë në këtë qendër"

"Menaxheri i rastit tim u përpoq të na jepte zgjidhje."

"Kam qenë e kënaqur nga shërbimet e ofruara nga forumi i Grave në Elbasan, por jo e kënaqur me shërbimet e dhëna nga bashkia."

Përfundime

Nga analiza e të dhënave demografike, është e qartë se gratë që i kanë mbijetuar dhunës në familje shoqërohen nga një situatë e vështirë socio-ekonomike. Shumë prej tyre kanë fëmijë të mitur dhe nuk i kanë zgjidhur plotësisht problemet e tyre me dhunuesin. Shumë prej tyre kanë edhe probleme serioze me strehimin dhe punësimin. Në lidhje me sigurinë e tyre, shumë gra kthehen të jetojnë me familjet e tyre, prindërit ose të afërmit, pasi kanë raportuar dhunën dhe pasi marrin urdhra mbrojtjeje, pasi shteti shqiptar nuk siguron rregullsi në strehimin e viktimave të dhunës në familje. Nga analiza se si qendrat e shërbimeve sociale i trajtojnë rastet kuptohet se shërbimi nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Nga analiza e përgjigjeve të grave është e qartë se zyrtarët nuk i kanë të qarta detyrat e tyre dhe nuk i kryejnë siç duhet në raport me gratë që i mbijetojnë dhunës. Është e qartë se qendrat nuk ofrojnë mbulim të plotë për të gjitha nevojat e grave si mbështetje psikologjike dhe sociale, vend të sigurt, mundësi pune, kujdes të përkohshëm për fëmijët. Jo të gjithë menaxherët e rasteve ose punonjësit socialë krijojnë një plan për gratë dhe e ndjekin atë hap pas hapi. Pjesa më e madhe e mbështetjes social - psikologjike jepet nga organizatat e grave. Pothuajse të gjitha gratë vunë në dukje se QShS-ja i kishte referuar tek OJQ-të e grave për të marrë lloje të ndryshme ndihme. Pavarësisht numrit të grave të kënaqura me shërbimet dhe me asistencën e qendrës së shërbimeve sociale, prapëseprapë numri i grave të pakënaqur është i konsiderueshëm dhe një lloj thirrjeje për ndryshim drejt shërbimeve më të mira prej disa agjencive së bashku dhe një koordinimi më të mirë për gratë që i kanë mbijetuar dhunës në familje.

Përvojat e grave që i kanë mbijetuar dhunës dhe që kanë marrë mbështetje nga organizata e grave.

I njëjti grup grash u intervistua në lidhje me kënaqësinë me shërbimet e ofruara nga OJQ-të e grave. OJQ-të e vlerësuara përfshijnë 8 OJQ grash:

1. Linja e Këshillimit për Vajzat dhe Gratë
2. Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Abuzuara
3. Forumi i Gruas në Elbasan (Elbasan)
4. Gruaja te Gruaja - Gratë për Gratë (Shkodër)
5. Qendra Psikosociale Vatra - Vlorë
6. Shoqata Jona - Sarandë
7. Unë Gruaja - Pogradec
8. Agritra - vizion - Dibër

Përdoruesve të shërbimeve, iu kërkua të vlerësonin shkallën e kënaqësisë me shërbimet e organizatave të grave të **linjës telefonike SOS për mbështetje psikologjike / sociale** . 49 (dyzet e nëntë) gra deklaruan se ndihen shumë të kënaqura me shërbimet, ndërsa 22 (njëzet e dy) janë disi të kënaqura, pasuar nga 7 (shtatë) të pakënaqura, ndërsa 13 gra nuk e kishin përdorur këtë linjë.

Disa deklaratat pozitive që mbështesin vlerësimin:

- *"U ndjeva e qetë dhe e kënaqur duke biseduar me këshilluesen"*
- *"Komunikim shumë i mirë me këshillueset".*
- *"I kam marrë më shumë shërbime në zyrë, por kur kam komunikuar në telefon me psikologun, më ka ndihmuar shumë, veçanërisht për nevojat e fëmijëve që kanë probleme të mëdha psikologjike".*
- *"Kam biseduar disa herë në telefon me psikologun dhe kam marrë këshilla të vlefshme."*
- *"Unë komunikoj shumë me psikologun dhe ai më ka këshilluar disa herë në telefon kur nuk kam qenë në gjendje të vij në zyrë nga pandemia ose për shkak të distancës. Më ka ndihmuar shumë".*
- *"Bisedë telefonike mjaft e mirë, më mbështetën që në fillim"*
- *"Psikologët më kanë mbështetur jashtëzakonisht shumë dhe unë jam bërë e vetëdijshme për këshillat e tyre përmes linjës telefonike"*

Përdoruesve të shërbimeve, iu kërkua të vlerësonin shkallën e kënaqësisë me shërbimet e organizatave të grave të linjës telefonike **SOS për mbështetje ligjore**. Ky shërbim nuk është përdorur nga asnjë grua e intervistuar. Ato thanë se nuk dinë asnjë numër telefoni për këtë lloj mbështetjeje.

Përdoruesve të shërbimeve iu kërkua të vlerësonin shkallën e kënaqësisë me shërbimet e organizatave të grave të **këshillimit psikologjik / social individual dhe fizikisht**. 68 (gjashtëdhjetë e tetë) gra deklaruan se ndihen shumë të kënaqura me këto shërbime, ndërsa 22 (njëzet e dy) janë deri diku të kënaqura, pasuar nga 1 (një) e pakënaqur.

Përdoruesve të shërbimeve iu kërkua të vlerësonin shkallën e kënaqësisë me shërbimet e organizatave të grave si **konsultat ligjore individuale dhe fizikisht**. 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) gra deklaruan se ndihen shumë të kënaqura me këto shërbime, ndërsa 17 (shtatëmbëdhjetë) janë deri diku të kënaqura, pasuar nga 7 (shtatë) të pakënaqura.

"Kam marrë mbështetje ligjore me një avokat nga shoqata, ata më mbështetën me gjithçka që më duhej".

"Jam shumë i kënaqur. Kam marrë shërbim juridik dhe psikologjik për vete dhe për fëmijët. Këshilltari ligjor më ndihmoi në procesin e divorcit. Gjithçka ofrohet falas. Përndryshe, nuk isha në gjendje të vazhdoja proceset".

"Jam këshilluar vazhdimisht nga avokati për çështjen e KEMP"

"Kemi marrë shërbime familjare ligjore nga avokati i Qendrës dhe jam shumë e kënaqur."

"Jam shumë e kënaqur që kam marrë ndihmë juridike falas për divorcin dhe për të gjitha procedurat ligjore"

Përfundime

OJQ-të e grave që kanë krijuar një linjë të qëndrueshme për mbështetjen psikosociale dhe qendrat rezidenciale për gratë që i mbijetojnë dhunës në familje. OJQ-të e Grave ofrojnë edhe shërbime falas të ndihmës juridike dhe mbështetje social-ekonomike për gratë. OJQ-të e grave koordinojnë edhe veprimet për raste të ndryshme me qendrat e shërbimeve sociale. Sidoqoftë, numri i grave që marrin shërbime është më i vogël se numri i përgjithshëm i grave që raportojnë dhunë në familje në komisaritet e policisë ose numri i grave që marrin Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje. Gjithashtu, nuk kemi informacion mbi linjat telefonike për ndihmën juridike falas. Ata i përdorin këto linja, por përmes OJQ-ve të grave.

Referencat

Këshilli i Evropës, 2011. Konventa e Stambollit. Marrë nga <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000168046031c>

GREVIO Raporti i vlerësimit bazë për Shqipërinë. Marrë nga <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

INSTAT, 2020 Gratë dhe Burrat në Shqipëri. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2020/burrat-dhe-grat%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2020/>

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Marrë nga https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

Ligji për Masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Marrë nga <https://www.parlament.al/Files/Akte/20201020140600ligj%20nr.%20125%20dt.%2015.10.2020.pdf>

Liz Kelly. 2018 Hartëzimi i Shërbimeve Mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në përputhje me Standardet e Konventës së Stambollit. Marrë nga, <https://rm.coe.int/eng-mapping-support-services/16809981db>

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, 2016 - 2020 Marrë nga, https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf

Shërbimi Social Shtetëror 2019. Vlerësimi i nevojës për shërbime sociale në 12 qarqe të Shqipërisë. Marrë nga <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/pVariation/vleresimi-i-nevojes-per-sherbime-shogerore-ne-12-qarqet-e-shqipe.html>

VKM 518. Marrë nga http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2014/03/VKM-518_dt_04.09.2018.pdf